VENDIM
Nr. 160, datë 14.4.2017

PËR SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORISË SË PËRGJITHSHME PËR FUNKSIONARIN PUBLIK Z. ARDIAN MARKU, ANËTAR I KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015, "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 14.4.2017, me pjesëmarrjen e:

Denar	Biba	kryetar
Hysen	Osmanaj	zv/kryetar
Bledar	Skënderi	anëtar
Edlira	Jorgaqi	anëtare
Gëzim	Veleshnja	anëtar
Klement	Zguri	anëtar
Vera	Shtjefni	anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

OBJEKT: Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Ardian Marku, anëtar i këshillit të Bashkisë Lezhë, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

BAZË LIGJORE: Neni 1, neni 10, pika 1, germa "d", neni 14, neni 15, pika 3 i ligjit 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, pika 12, 13, 14 i vendimit të Kuvendit nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", KQZ është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për subjekte si më poshtë:

Deputetët të Kuvendit të Shqipërisë;

Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave që nuk është deputet;

Kryetarit të bashkisë apo këshilltarit në këshillin bashkiak.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Ardian Marku, anëtar i Këshillit të Bashkisë Lezhë, rezulton se ka një dënim me vendimin nr.129, datë 24.11.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me 4 muaj burgim (në aplikim edhe të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale), parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal "Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit".

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka dërguar në KQZ, vërtetimin e gjendjes gjyqësore të datës 27.05.2016, të z. Ardian Marku sipas të cilit rezulton se: z. Marku me vendim gjyqësor të formës së prerë, nr. 182, datë 01.12.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për kryerjen e veprave penale, "Kontrabandës me mallra të tjera", parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal, është dënuar me 200.000 lekë gjobë si dhe për kryerjen e veprës penale "Përdorimi i dokumenteve të falsifikuar", parashikuar nga neni 186/1 të Kodit Penal, është dënuar me 100.000 lekë gjobë.

Sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore, për këtë vepër penale, në bazë të nenit 69 të Kodit Penal, është rehabilituar.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka ridërguar edhe njëherë në KQZ, Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore datë 25.01.2017, të z. Ardian Marku (Nikulaj) sipas të cilit rezulton se, përveç dënimit të mësipërm, me vendim gjyqësor të formës së prerë nr.129, datë 24.11.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, është dënuar me 6 muaj burgim, për veprën penale "Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit", parashikuar nga neni 278 paragrafi 2 i Kodit Penal.

Sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore, për këtë vepër penale, në bazë të nenit 69 të Kodit Penal, është rehabilituar.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit dhe në të dy Vërtetimet e Gjendjes gjyqësore, rezulton se z. Ardian Marku, nuk e ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit dënimin për veprën penale "Kontrabandës me mallra të tjera", parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal sipas vendimit nr.182, datë 1.12.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me shkresën nr.3240/1 prot., datë 7.2.2017, ka dërguar në KQZ në formatin elektronik (CD), listën pjesore të anëtarëve të Këshillave Bashkiakë, të verifikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ku rezulton se; më datë 20.3.2003 z. Ardian Marku ka ndryshuar mbiemrin nga "Nikulaj" në "Marku" i cili është deklaruar edhe në formularin e vetëdeklarimit.

Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr.303/1, datë 20.3.2017 i ka kërkuar KQZ-së verifikimin e të dhënave të deklaruar në formularin e vetëdeklarimit të z. Ardian Marku. KQZ-ja pas shqyrtimit të të dhënave në dokumentacionin e z. Ardian Marku, vendosi t'ia kalojë rastin për kontroll të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme.

Më shkresën nr.303/5, datë 04.04.2017, Prokuroria e Përgjithshme, ka dërguar në KQZ vendimin e rezultatit të verifikimit për z. Ardian Marku, me detyrë anëtar i këshillit të Bashkisë Lezhë.

Prokuroria e Përgjithshme ka analizuar veprën dhe dënimin e vendimit nr.129, datë 24.11.2003, të Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë dhe ka konkluduar se:

Neni 2, pika 1, germa "a" e ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ndalohen të zgjidhen të emërohen apo të ushtrojnë një funksion publik personat që kryejnë një krim të parashikuar nga neni 278 paragrafi i parë, i pestë i gjashtë, i Kodit Penal.

Në momentin që ka hyrë në fuqi ligji nr.138/2015, neni 278, parashikon përkatësisht këto paragrafë:

- (1)prodhimin e armëve dhe municioneve luftarake;
- (5)mbajtjen e armëve, të bombave apo minave, ose lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të automatizuar, në mjedise publike;
- (6)kur vepra penale është kryer në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë, ose ka sjellë pasoja;

Nëse i referohemi rastit konkret, në arsyetimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, në vendimin e sipërcituar, sqarohet se subjekti e ka kryer veprën penale të armëmbajtjes pa leje, në mjedise publike, (në makinë, në rrugë)..... (Gjatë kontrollit të ngritur nga forcat e policisë së Komisariatit Lezhë, kanë ndaluar automjetin tip benz, të cilin e drejtonte Ardian Marku dhe gjatë kontrollit të ushtruar në të, poshtë sediljes së shoferit, është gjetur një armë e tipit TT, nr.26844 të cilën i pandehuri e mbante pa leje të organeve kompetente.....) Pavarësisht se në momentin e kryerjes së veprës penale, dispozita e nenit 278 të Kodit Penal nuk e parashikonte si paragraf të ndarë më vete (armëmbajtjen pa leje në mjedise publike) dhe pavarësisht faktit që ky nen ka ndryshuar disa herë ndër vite, ligji nr.138/2015 përcakton qartësisht se në vlerësim të anës objektive, armëmbajtja pa leje në mjediset publike përfshihet si ndalim në nenin 2, pika 1, germa "a" e ligjit nr.138/2015.

Prokuroria e Përgjithshme në vlerësim të anës objektive ka ndryshuar referencën e dispozitës të Kodit Penal, për klasifikimin e veprës penale për të cilën z. Ardian Marku ka marrë dënimin me burgim sipas vendimit nr.129, datë 24.11.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, nga neni 287, paragrafi 2 i Kodit Penal, në kohën e kryerjes së veprës penale, në nenin 287, paragrafi 5 të Kodit Penal në fuqi në kohën e miratimit të ligjit nr.138/2015.

Në përfundim Prokuroria vendosi përfundimin e verifikimeve dhe konstatimin se subjekti deklarues z. Ardian Luigj Marku, me detyrë drejtor ALUIZNI, Lezhë dhe anëtar i këshillit Bashkiak Lezhë përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, pika 1, germa "a" të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Nga verifikimi i dokumentacionit, formularit të vetëdeklarimit, vërtetimit të gjendjes gjyqësore, KQZ-ja konstaton se:

Zoti Ardian Luigj Marku anëtar i Këshillit Bashkiak Lezhë, është dënuar në vitin 2003 për kryerje të veprës penale "Prodhimi dhe mbajta pa leje e armëve luftarake dhe e municioneve", parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.

Ne ligjin nr.138/2015 në nenin 2 pika 1 germa "a", veç te tjerash thuhet se: "… nuk mund të kandidojë e as të zgjidhen deputet në Kuvendin e Shqipërisë, Kryetar Bashkie apo Këshilltar në Këshillat Bashkiak … personat që janë dënuar me vendim të formës së prerë brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për: a) kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale, sipas neneve….278, paragrafi i parë, i pestë dhe i gjashtë…".

Në kohën e dënimit të zotit Ardian Luigj Marku vepra penale e "Prodhimi dhe mbajta pa leje e armëve luftarake dhe e municioneve", parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal kishte tre paragrafë dhe në paragrafin e dytë dispozita parashikonte një dënim i cili varionte nga gjobë deri në 7 vjet burgim.

Në vendimin e datës 3.4.2017 të Prokurorisë së Përgjithshëm, është bërë një interpretim i vendimit penal të dënimit të zotit Ardian Luigj Marku, duke analizuar njërin prej elementeve të veprës penale, atë të anës objektive.

Prokuroria e Përgjithshme thotë midis të tjerash në vendimin e saj se:

"… nëse i referohemi rastit konkret, në arsyetimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, në vendimin e sipërcituar, sqarohet se subjekti e ka kryer veprën penale të armëmbajtjes pa leje në mjedise publike. Pavarësisht se në momentin e kryerjes së veprës penale, dispozita e nenit 278 të Kodit Penal, nuk e parashikonte si paragraf të ndarë më vete armëmbajtjen pa leje në mjedise publike, dhe pavarësisht faktit se ky nen ka ndryshuar disa herë ndër vite siç e aryetuam më sipër ligji nr.138/2015, përcakton qartësisht se në vlerësim të anës objektive armëmbajtja pa leje në ambiente publike përfshihet në ndalimet e nenin 2 pila 1 germa "a" e këtij ligji....".

Në lidhje me këtë arsyetim të vendimit të Prokurorisë së Përgjithshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shprehet se:

Së pari, Prokuroria e Përgjithshme sipas ligjit nr.138/2015, ngarkohet që të bëjë verifikim të thelluar të të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit, me iniciativë të saj apo edhe me kërkesë të institucioneve përkatëse. Pra ky organ, sipas këtij ligji është i detyruar që të administrojë vendime penale dënimi, vendime arresti brenda e jashtë vendit, urdhra dëbimi etj.

Në interpretimin që i ka bërë vendimit penal me nr.123, datë 24.11.2003, dhe më konkretisht anës objektive të veprës penale të kryer nga subjekti vetëdeklarues, ky organ në vendimin e tij të datës 03.04.2017, nuk u ka dhënë përgjigje disa dyshimeve dhe konkretisht:

- Ku qëndron ngjashmëria midis nenit 278 (sipas parashikimit të ligjit penal të kohës, të vitit 2003) për të cilën është dënuar subjekti vetëdeklarues Ardian Marku i cili e ka masën e dënimit nga gjobë deri në 7 vjet burgim, dhe nenit 278 (ligji penal në aktual) që i referohet Prokuroria i cili e ka masën e dënimit nga 3 deri në 7 vjet burgim ?

Lehtësisht dallohet një diskordancë shumë e madhe me masat e dënimit të cilat patjetër kanë qenë kritere në caktimin e dispozitave me karakter përjashtues në zbatim të ligjit 138/2015. Pra, legjislatori, ndryshe nga sa ishte parashikuar më parë ka vendosur një masë dënimi dysheme më të madhe se sa parashikohej në vitin 2003, gjë e cila do të thotë një qëndrim i ashpër në lidhje me këtë veprimtari antiligjore. Cila ka qenë arsyeja e barazimit të këtyre dispozitave për llogari të ligjit 138/2015 nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme?

- Njohjen apo interpretimet e vendimeve penale, legjislacioni penal shqiptar këtë të drejtë ia njeh vetëm organeve gjyqësore. Janë këto organe që mund dhe duhet që të bëjnë interpretimin e vendimeve penale. A jemi përpara tejkalimit të veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme kur ajo interpreton vendimin gjyqësor, anën objektive të veprës penale për të cilën është dënuar subjekti vetëdeklarues?

Së dyti, dispozita penale të cilës i referohet organi i akuzës ka një masë dënimi nga 3 deri në 7 vjet burgim c'ka tregon seriozitetin që ligjvënësi i kushton kësaj veprimtarie keqbërëse. Ashpërsimi i masës së dënimit në minimum, referuar qëndrimit të Prokurorisë së Përgjithshme, duket se ndodhemi përpara një cilësimi të ri të veprës penale të kryer nga subjekti vetëdekalrues z. Ardian Marku në vitin 2003. Është parim i gjithëpranuar në doktrinën e së drejtës penale se ligji penal ndëshkues nuk ka fuqi prapavepruese. Ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese.. Theksojmë se sa më sipër, është në përputhje të plotë edhe më parashikimet e nenit 29 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

As Prokuroria e Përgjithshme e aq më pak Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk mund të ngrenë akuzën jashtë një procesi gjyqësor. Janë këto dallime midis veprës së kryer dhe asaj që i referohemi për heqjen e mandatit, që e kanë lejuar gjykatën për të aplikuar lehtësirat e parashikuara në ligjin penal.

Detyrat dhe funksionet e organit të prokurorisë janë të mirëpërcaktuara në një grupim ligjesh, duke filluar nga:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e cila në nenin neni 148 të saj, paragrafi i parë parashikon shprehimisht se:

"1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj. Detyra konkrete të saj janë parashikuar në ligjin organik të saj e konkretisht në ligj".

- Ligjin nr.97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", neni 3 Objekti i veprimtarisë së prokurorisë ku parashikohet shprehimisht se:

"1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e Policisë Gjyqësore, si dhe kryen detyra të tjera të caktuara me ligj".

- Në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ligj i cili në asnjë rast nuk e ka ngarkuar prokurorinë me funksione dhe detyra gjyqësore, por i ka marrë të mirëqena detyrat dhe funksionet që ligjet e sipërcituara i kanë ngarkuar asaj.

- Në vendimin nr. 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" të Kuvendit të Shqipërisë, vendim i cili jo vetëm në tërësinë e tij por edhe në veçanti në kreu V. "Procedura e realizimit të verifikimit" të tij i ka ngarkuar Prokurorisë detyra aspak të ngjashme me ato gjyqësore, por thjesht dhe vetëm në përputhje me detyrat dhe funksionet e saj të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet e sipërcituara.

Vendimi i Prokurorisë së Përgjithshme i cili kërkon heqjen e mandatit për shkaqe të paraqitura në qëndrimin e tij, nuk qëndron, pasi veprës penale të ndodhur në vitin 2003 përfaqësuesi i Prokurorisë së Përgjithshme i ka dhënë një cilësim të ri juridik, tashmë sipas parashikimeve ligjore të vitit 2017.

Megjithatë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vlerëson se vepra penale e parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, për të cilën akuzohet dhe është dënuar z Adrian Marku, nga pikëpamja e teknikës legjislative, është vepër penale e cila pozicionuar në seksionin e III të kreut VIII të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal, kreu i cili titullohet "Krime kundër autoritetit të shtetit".

Qëllimi i ligjit nr.138/2015 është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimit nga funksioni publik të personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen të krimeve, sipas këtij ligji.

Objekti i këtij ligji është mbrojtja dhe garantimi i mirëfunksionimit demokratik të Kuvendit, organeve të qeverisjes vendore, institucioneve kushtetuese apo të krijuara me ligj, administratës publike, nga ndikimi apo pjesëmarrja në politikbërje dhe/ose vendimmarrje e personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie, ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, sipas këtij ligji.

Qëllimi i ligjit nr.138/2015 shprehet edhe në procesverbalin e Komisionit te Posaçëm Parlamentar për Zbatimin e Problematikës në Rezolutën për Marrëveshjen midis Maxhorancës Qeverisëse dhe Opozitës në Kuvendin e Shqipërisë (Dokument parlamentar), datë 20.11.2015, ora 09:00, ku citohet shprehimisht se:

"… qëllimi i këtij ligji është qartazi ai për të mbrojtur institucionet dhe për të garantuar funksionimin demokratik të tyre, duke përjashtuar nga funksionimi dhe nga vendimmarrja e këtyre institucioneve, nga politikbërja, të gjithë ata persona që sot janë në detyrë, apo në të ardhmen, do të synojnë të vijnë në këto institucione, por ndërkohë janë persona të cilët kanë rekorde kriminale.

Pra, qëllimi i këtij projektligji është të mbrojë funksionimin, vendimmarrjen dhe politikbërjen e institucioneve demokratike të administratës publike, nga persona, të cilët kanë rekorde kriminale dhe për këtë arsye konsiderohet me vend që këta të përjashtohen, të largohen nga këto procese të rëndësishme[1]".

Pra, në mënyrë të drejtpërdrejtë veprimtaria për të cilën është dënuar subjekti vetëdeklarues z. Ardian Marku, bie ndesh me qëllimin dhe objektin e ligjit nr.138/2015, i cili në finale ka mirëfunksionimin e

[1] Procesverbali i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për zbatimin e Problematikës në Rezolutën për Marrëveshjen midis Maxhorancës Qeverisëse dhe Opozitës në Kuvendin e Shqipërisë (Dokument parlamentar), datë 20.11.2015, ora 09:00, faqe 2

institucioneve shtetërore në përgjithësi dhe në rastin konkret mirëfunksionimin e organeve të qeverisjes vendore në veçanti.

Me fjalë të tjera Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, vlerëson se ligji nr.138/2015, nuk është dhe nuk duhet të aplikohet si një ligj penalizues, por si një ligj garantues i mirëfunksionimit të aparatit shtetëror.

Ligji nr.138/2015, nga pikëpamja e teknikës legjislative, është hartuar në mënyrë të tillë që e përcakton llojin e veprës penale dhe masën e dënimit si kushte Ndalimi për kandidim dhe për t'u zgjedhur në një funksion të lartë publik. Kjo gjë del qartazi edhe në procesverbalin e Procesverbali i Komisionit te Posaçëm Parlamentar për Zbatimin e Problematikës në Rezolutën për Marrëveshjen midis Maxhorancës Qeverisëse dhe Opozitës në Kuvendin e Shqipërisë (Dokument parlamentar), datë 20.11.2015, ora 09:00 ku citohet më poshtë shprehimisht se:

"Ky projektligj për herë të parë përcakton në kuadrin legjislativ shqiptar kufizime, të cilat lidhen në mënyrë proporcionale me shkallën e rrezikshmërisë sociale të personave, të cilët kanë kryer krime në të shkuarën apo eventualisht në të ardhmen, do të kryejnë krime dhe do të dënohen apo janë në proces gjykimi nga drejtësia për krimet që janë kryer. Mbi bazën e këtyre vendimeve të marra nga gjykatat apo masave të lëshuara nga autoritet gjyqësore apo autoritete të tjera, personat do të kufizohen për të ushtruar funksione publike apo për t'u zgjedhur për periudha të caktuara, që fillojnë nga periudha e ndalimit përjetë, për persona që kanë kryer krime të rënda, deri në periudha më të shkurtra në vartësi të shkeljes dhe krimit që ata kanë bërë.

"... te neni 2. Kushtet e kandidimit për t'u zgjedhur. Është një nen i detajuar. Pika 1 ka katër paragrafë që detajojnë, po themi kriteret e ndalimit për kandidim, për zgjedhje, për emërim dhe për ushtrim funksioni. Grupi i parë janë po themi, krimet e rënda. Grupi i dytë janë veprat penale të korrupsionit dhe zgjedhjeve të lira. I treti janë dënime me dy vjet e sipër, pra ka një lloj graviteti, dhe ato që janë gjashtë muaj e sipër, por që e kanë më të shkurtër periudhën e ndalimit. Qëllimi i tij është proporcionaliteti. Proporcionaliteti në këtë ndalim, mbi bazën e asaj që është caktuar më parë nga gjykatat, për krimin që kanë kryer..."[2].

Në paragrafin e parë të nenit 2 të tij, i vetmi neni që bën diferencën me nenet e tjerë, që janë cituar të plotë dhe në tërësinë e tyre, është neni 278, që bën referime në 3 paragrafë të tij, dhe jo në tërësinë e tij. Për këtë grupim veprash penale ligji nr.138/2015 ka parashikuar ndalimin për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të mandatit zgjat gjatë gjithë jetës. Pra, janë konsideruar vepra penale të rënda.

Qëllimi i një zgjedhje të tillë legjislative është për të shmangur praninë në kuvendet e zgjedhura, personat e gjykuar moralisht si të padenjë. Ndërkohë që kemi një ligj, i cili nuk parashikon penalizimet, përtej asaj çfarë është penalizimi i bërë nga gjykatat, për veprat penale të personave, të cilët duhet të largohen nga funksionet publike, të zgjedhura apo të emëruara. Pra, ky ligj synon vetëm mbrojtjen e institucioneve demokratike nga influenca në politikëbërje dhe vendimmarrje të këtyre individëve[3]. Pra qëllimi i legjislatorit është shprehur qartë që askush nuk mund të dalë tej vendimeve të gjykatave, qoftë edhe nga organi i porkurorisë.

Ligji nr.138/2015, "Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", duke disiplinuar kushtet dhe kërkesat për të hyrë dhe për të mbajtur një detyrë apo funksion publik, legjislatori përpiqet të vendosë një balancim ndërmjet të drejtës së elektoratit pasiv, apo subjektit të emëruar nga njëra anë dhe mbarëvajtjen apo mirëfunksionimin e administrativ nga ana tjetër.

Balancimi delikat ndërmjet të drejtave të elektoratit pasiv dhe mbrojtjes së funksionimit të mirë të administratës publike, është një çështje që edhe nga praktika e vendeve të zhvilluara4 është trajtuar deri në nivel kushtetues dhe konkluzioni ka qenë se ka një interes të përgjithshëm publik për të shmangur një rol aktiv të shkelësve në vendimmarrjen politike. Interesi publik prevalon ndaj interesave të individëve, qofshin këta edhe të zgjedhur.

Interesi publik lidhet me qëllimin e normës ligjore në këtë rast, që është, garantimi i besueshmërisë së

---

[2] Procesverbali i Komisionit te Posaçëm Parlamentar për Zbatimin e Problematikës në Rezolutën për Marrëveshjen midis Maxhorancës Qeverisëse dhe Opozitës në Kuvendin e Shqipërisë (Dokument parlamentar), datë 20.11.2015, ora 09:00, Faqe 18

[3] Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Zbatimin e Problematikës në Rezolutën për Marrëveshjen midis Maxhorancës Qeverisëse dhe Opozitës në Kuvendin e Shqipërisë (Dokument parlamentar), procesverbal datë 23.11.2015, ora 18:00, faqe 2

[4] Për më gjerë, shiko sentenca nr. 236, viti 2015 Gjykata Kushtetuese italiane

administratës ndaj publikut, do të thotë, raporti i besimit të qytetarëve ndaj institucioneve dhe interpretimi i Komisionit Qendror të zgjedhjeve në këtë rast duhet të jetë dhe është i lidhur ngushtësisht me ratio –n e ligjit.

Nuk duket e paarsyeshme që, duke qenë se mund të dyshohet se ndotet ose të humbasë imazhi i aparatit publik, që mund të rrjedhë nga vazhdimi në detyrë i një funksionari në kushtet ligjore që shpjeguam më sipër.

Përballë një situate të rëndë paligjshmërie në administratën publike, në fakt nuk është e paarsyeshme marrja e një vendimi për subjektin vetëdeklarues që ka kryer krimin në fjalë (përsa kohë është një krim që është drejtuar kundër autoritetit të shtetit] të vijohet me vendimmarrjen e heqjes së mandatit të subjektit vetëdeklarues, për të evituar një "ndotje" të administratës publike dhe për të garantuar "besueshmërinë" e administratës publike ndaj publikut, që do të thotë raporti i besimit ndërmjet qytetarëve drejt institucioneve që mund të rrezikojë të plasaritet nga "hija" rënduese mbi të, për shkak të akuzës me të cilën është goditur një person nëpërmjet të cilit vetë institucioni vepron"[5]

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vlerëson, se heqja e mandatit të një anëtari të zgjedhur të një bashkie, dënuar me 6 muaj burgim, për një vepër penale të rëndë dhe të drejtuar kundër autoritetit të shtetit, është e justifikuar racionalisht nga qëllimi për të shmangur praninë në një organ demokratik të një personi i cili është moralisht i padenjë. "Kur një kriminel apo një hajdut bën faj dhe kapet, rregulli bazë është që nuk përfiton dot nga produkti i veprës së tij[6]".

Përveç sa më sipër, referuar edhe në tërësinë e tij raportit paraprak, "Për përjashtimin e shkelësve të ligjit nga parlamenti", opinioni nr.807/2015 të Komisionit Evropian për Demokraci përmes ligjit (Komisioni i Venecias), miratuar nga Këshilli i Zgjedhjeve Demokratike, në mbledhjen e tij të 51-të (Venecia, 18 qershor 2015) dhe nga Komisioni i Venecias në sesionin e tij plenar të 103-të (Venecia, 19-20 qershor 2015), dhe në veçanti, paragrafëve 133 dhe 144 të tij cituar si më poshtë:

"133. siç thuhet dhe në vendimin e Gjykatës Europiane për të drejtat e njeriut, shtrëngimet duhet të kufizohen për aq sa është e nevojshme për të siguruar funksionimin e duhur të demokracisë, e cila do të rrezikohej më seriozisht nga një zyrtar i zgjedhur se sa nga një votues i thjeshtë që ushtron të drejtën e tij zgjedhore aktive. Ato nuk duhet të konsiderohen si kufizues të demokracisë, por si një mjet për ta ruajtur atë", dhe

144. Në rast se deputeti akuzohet se ka kryer një krim të rëndë, mund të ketë një interes publik për të shmangur pjesëmarrjen e atij personi në Procedurat parlamentare. Mund të niset një procedurë heqjeje. Kushtetuta Finlandeze7 parashikon një lloj të tillë procedure të largimit nga detyra, për deputetët të cilët në thelb dhe në mënyrë të përsëritur kanë lënë pas dore detyrat e tyre si përfaqësues. Nuk ka asnjë kufizim për ata persona për të kandiduar në zgjedhjet e ardhshme".

Z. Adrian Luigj Marku me të dhënat për dënim për kryerjen e veprës penale, "Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit" vepër penale e cila pozicionuar në Seksionin e III të kreut VIII të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal, kre i cili titullohet "Krime kundër autoritetit të shtetit", është në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit, sipas parashikimeve të nenit 2, pika 1, germa "a", nenit 4, pika 1 të ligjit nr.138/2015.

Për sa më sipër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referuar nenit 179/1 të Kushtetutës, nenit 14 dhe nenit 10, pika 1, germa "d" shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Lezhë z. Adrian Luigj Marku.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 1, neni 10, pika 1, germa "d", neni 14, nenin 15, pika 3 i ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, pika 12, 13, 14 i vendimit të Kuvendit nr.17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, "Për garantimin e

[5] Për më gjerë, shiko sentenca n. 206, viti 1999 Gjykata Kushtetuese Italiane

[6] Komision i Posaçëm Parlamentar për Zbatimin e Problematikës në Rezolutën për Marrëveshjen midis Maxhorancës Qeverisëse dhe Opozitës në Kuvendin e Shqipërisë Dokument parlamentar PROCESVERBAL Datë 16.09.2015, ora 14:00, faqe 5

[7] *Neni 28*

integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

VENDOSI:

1. Të shpall të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të anëtarit të këshillit të Bashkisë Lezhë z. Ardian Luigj Marku.

2. Ky vendim i njoftohet menjëherë Kryeministrit.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Denar Biba